# RAPORTI VJETOR

# 2013



SiCRED
Shoqëri Sigurimi Jete

| Të dhënat për SiCRED sh.a. (dhjetor 2013): | |
|---|---|
| Primi total i shkruar për 2013 | 269,462 mijë lekë |
| Numri i klientëve: | 47,289 |
| Dëmet e paguara në total: | 22,279 mijë lekë |
| Numri i dëmeve të paguara: | 299 |
| Kapitali Aksionar: | 473,300 mijë |
| Numri i stafit: | 47 |
| Numri i degëve dhe agjencive: | 11 |

# TABELA E PËRMBAJTJES

1. Hyrje

2. Pronësia dhe Organet Drejtuese të SiCRED sh.a.

3. Zhvillimet kryesore gjatë vitit 2013

   3.1. Treguesit financiarë kryesorë në periudhën 2009-2013

   3.2. Projekti me CREDINS Bank

   3.3. Bashkëpunimi me SiCRED Pensions

   3.4. Rikonstruktimi i rrjetit të degëve

   3.5. Zgjerimi i rrjetit mjekësor

4. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

5. Zhvillimet kryesore gjatë 2013 për SiCRED Pensions

6. Zhvillimet kryesore gjatë 2013 për SiCRED Assistance

7. Objektivat për vitin 2014

8. Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

9. Rrjeti i Degëve dhe Agjencive

# Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm

Viti 2013 ka qenë një vit i qëndrueshëm për shoqërinë tonë, gjatë të cilit kemi arritur të realizojmë objektivat e vendosura, duke ruajtur pozita pothuaj të njëjta me vitin 2012, pavarësisht kushteve ekonomike jo fort të favorshme në vendin tonë dhe situatës ekonomike në mbarë rajonin.

Numri i të siguruarve të shoqërisë së sigurimit SiCRED sh.a., në fund të vitit 2013 ishte mbi 47 mijë klientë. Aktivi total është rritur me 7.53 % gjatë vitit 2013, duke arritur në rreth 1,08 miliard lekë. Gjatë këtij viti, primi bruto i shkruar nga SiCRED sh.a., ka qenë rreth 221 milion lekë, me një rritje prej 7% krahasuar me një vit më parë. Pagesat për dëmet kanë qenë mbi 22 milion lekë, me një ulje të lehtë rreth 5.5% më pak krahasuar me vitin 2012.
Viti 2013 ka sjellë zhvillime pozitive dhe për dy shoqëritë e tjera të grupit SiCRED.

Gjatë këtij viti vlera neto e aseteve të fondit të pensionit "SiCRED Pensions" të administruar nga Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit SiCRED sh.a., u rrit me 66.70% krahasuar me vitin 2012, me një kthyeshmëri mbi investimin prej 6.32%. Numri i anëtareve në fund të vitit 2013 ishte 1,836 përkundrejt 1,723 që ishin në fund të vitit 2012.

Viti 2013 ka shënuar vitin e parë të aktivitetit për shoqërinë konsulente SiCRED Assistance sh.p.k.. Gjatë këtij viti, nëpërmjet kontratave të konsulencës të lidhura me disa punëdhënës privatë, shoqëria u ka shërbyer rreth 700 punëmarrësve duke i asistuar në përmbushjen me sukses të kërkesave të autoriteteve shtetërore për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Filozofia jonë e biznesit është e orientuar drejt krijimit dhe ruajtjes së marrëdhënieve afatgjata të biznesit, e ndaj gjej këtu rastin për të falënderuar klientët tanë, partnerët dhe bashkëpunëtorët, të cilët na kanë besuar për të disatin vit radhazi, e pa mbështetjen e të cilëve nuk do të ishim këtu. Falënderoj gjithashtu, klientët që për herë të parë gjatë vitit 2013 kanë zgjedhur t'i besojnë shoqërisë SiCRED për sigurimin e tyre, duke uruar që të kemi përmbushur pritshmërinë e tyre. Premtimi ynë për të ardhmen është krijimi i një lidhje më të fortë me ju, përmes përmirësimit të vazhdueshëm të produkteve tona dhe punës së palodhur për zhvillimin e produkteve të reja.

Duke ju falënderuar Ju ftoj të ndajmë së bashku Raportin Vjetor të SiCRED sh.a. për vitin 2013.

Sinqerisht Juaji,
**Genc KOXHAJ**
Drejtor i Përgjithshëm





# 1 HYRJE

Viti 2013 ka qenë një vit i vështirë për ekonominë ndërkombëtare e atë shqiptare dhe në veçanti për sektorin e sigurimeve. Volumi i përgjithshëm i primit të sigurimit shënoi një rënie krahasuar me vitin 2012, ndërkohë që aktiviteti i sigurimit të jetës pati një përmirësim të lehtë krahasuar me periudhën e mëparshme. Pjesa më e madhe e shoqërive të Sigurimit të Jetës dhe Jo-Jetës kanë pasur një performancë të ulët lidhur me primet e shkruara dhe dëmet e paguara, deri edhe duke raportuar rezultat financiar negativ për vitin 2013. Shoqëria SiCRED arriti të mbyllë vitin 2013, duke ruajtur pozita pothuaj të njëjta me vitin 2012, me rezultat financiar pozitiv për të tetin vit radhazi.

**Vlen të përmendim përmbledhtazi zhvillimet kryesore gjatë këtij viti, si më poshtë:**

- SiCRED ka mbajtur në nivele të qëndrueshme pjesën e tij në tregun e sigurimeve të Jetës në nivelin 23% duke ruajtur pothuaj të njëjtat pozita si gjatë vitit 2012.
- Zyrat e reja qendrore të SiCRED kanë përfunduar duke dhënë një imazh më cilësor për klientët tanë dhe grupin SiCRED.
- Po punohet për të rritur numrin e shërbimeve dhe produkteve financiare, numrin e shoqërive që do të ofrojnë këto shërbime shtesë, e që do të operojnë brenda grupit, për të rritur maksimalisht sinergjitë.
- Konsolidimi i anëtareve ekzistues nga SiCRED PENSIONS, shtimi i anëtarëve të rinj dhe rritja e volumeve të menaxhimit të aseteve.
- Zhvillim pozitiv në shoqërinë SiCRED Assitance, rritje e të ardhurave të kësaj shoqërie gjatë vitit 2013.

# PRONËSIA DHE ORGANET DREJTUESE TË SICRED SH.A. 2

**Organet e larta drejtuese të shoqërisë përbëhen nga[1]:**

A. Asambleja e Aksionarëve
B. Këshilli Mbikëqyrës
C. Drejtoria e Përgjithshme

**A. Asambleja Aksionare e shoqërisë SiCRED sh.a., të renditur sipas kuotës së aksioneve, përbëhet nga:**

| | | Kuota Aksionare |
|---|---|---|
| 1. | Z. Aleksandër PILO | 46.30 % |
| 2. | Z. Renis TËRSHANA | 30.10 % |
| 3. | Z. Artan SANTO | 4.74 % |
| 4. | Z. Maltin KORKUTI | 4.74 % |
| 5. | Znj. Monika MILO | 4.74 % |
| 6. | Z. Kristino Kromidha | 4.13 % |
| 7. | Z. Arben TAIPI | 2.10 % |
| 8. | Z. Petraq SHOMO | 2.10 % |
| 9. | Z. Artan XHORI | 1.05 % |

**B. Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë SiCRED sh.a.:**

| | | |
|---|---|---|
| 1. | Z. Artan SANTO | Kryetar |
| 2. | Z. Artan XHORI | Anëtar |
| 3. | Z. Selman LAMAJ | Anëtar |

**C. Drejtoria e Përgjithshme:**


| | | |
|---|---|---|
| 1. | Z. Genc KOXHAJ | Drejtor i Përgjithshëm |

*1. Të dhënat janë deri në datën 31 Maj 2014.*


# 3 ZHVILLIMET KRYESORE GJATË VITIT 2013

## I Treguesit financiare kryesore të SiCRED (shoqëri sigurimi jete) në periudhën 2009-2013


Primi i shkruar bruto





Primi i Vitit Financiar





Numri i Klientëve:





Dëmet e paguara në total:




Numri i dëmeve të paguara:





Fitimi Bruto





Aktivi Total





Kapitali Themeltar




Rezerva Teknike




Numri i Stafit



# II Projekti me CREDINS Bank

Më shumë "Ekstra Përfitime"!
Gjatë vitit 2013, SiCRED në bashkëpunim me Bankës CREDINS, lancoi fazën e dytë të projektit të përbashkët për ofrimin e produkteve të sigurimit, grupeve të ndryshme të klientëve të bankës. Faza e dytë u përkrah nga më shumë se 6,300 klientë, të cilët përfituan gjatë vitit 2013 paketat e mëposhtme:

- **Përfitime Ekstra për Depozituesit:**
    1. Sigurimin e jetës falas
    2. Ulje deri në 40% në klinikat dhe spitalet e rrjetit mjekësor SiCRED
- **Përfitime Ekstra për Kartëmbajtësit VISA (pa overdraft):**
    1. Sigurimin e jetës falas
    2. Ulje deri në **40%** në klinikat dhe spitalet e rrjetit mjekësor **SiCRED**
- **Përfitime Ekstra për Kartëmbajtësit VISA (me overdraft):**
    1. Sigurimin e jetës falas
    2. Ulje deri në 40% në klinikat dhe spitalet e rrjetit mjekësor SiCRED

**Përveç grupeve të mësipërme, nga ky projekt përfituan edhe klientët *Elite Member*, të Bankës CREDINS, të cilëve iu ofrua:**

1. Sigurimi i jetës dhe shëndetit në udhëtim për një periudhë 1-vjeçare
2. Ulje deri në 40% në klinikat dhe spitalet e rrjetit mjekësor SiCRED

Duke parë suksesin e këtij produkti gjatë vitit 2013, projekti do të shtrihet edhe për një fazë të tretë për klientët e CREDINS Bank edhe në vitin 2014, por tashmë me një gamë edhe më të gjerë përfitimesh.

# III Bashkëpunimi me SiCRED Pensions

"Ekstra Përfitime" për anëtarët e SiCRED Pensions!
Në shtator të vitit 2013, SiCRED në bashkëpunim me Shoqërinë Administruese të Fondit të Pensionit SiCRED sh.a. (SiCRED Pensions), prezantoi për anëtarët e SiCRED Pensions paketën "Përfitime Ekstra". Nëpërmjet kësaj pakete të gjithë anëtarët e Fondit të Pensionit Vullnetar SiCRED Pensions, iu ofrua mundësia për të përfituar falas:

- Një sigurim jete me afat 1-vjecar.
- Zbritje në çmimet e rrjetit mjekësor SiCRED.

Deri në fund të muajit dhjetor 2013, nga ky bashkëpunim përfituan rreth 150 anëtare të fondit "SiCRED Pensions", dhe një interesim në rritje për të përfituar nga kjo ofertë, pati edhe në muajt e parë të vitit 2014.

# IV Rikonstruktimi i Rrjetit të Degëve

Në përputhje me strategjinë dhe objektivat afatgjata, për zgjerimin dhe rikonstruktimin e rrjetit të degëve, SiCRED ka përfunduar me sukses brenda vitit 2013, rikonstruktimin e degëve në Shkodër dhe Fier.
Gjatë vitit 2013 nisëm dhe rikonstruktimin e zyrave qendrore të SiCRED, proces i cili përfundoi në muajin mars 2014. Zyrat e reja, tashmë shërbejnë si seli qendrore për të 3 shoqëritë e grupit SiCRED, e konkretisht:

- Shoqëria e Sigurimit të Jetës SiCRED sh.a.
- Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit SiCRED sh.a.
- SiCRED Assistance sh.p.k.

Ambientet e reja ofrojnë më shumë hapësira dhe lehtësira të ndryshme për klientët tanë, duke përmirësuar cilësinë e shërbimit të ofruar ndaj tyre, si dhe kanë krijuar një ambient pune komfort për punonjësit tanë.

# V Zgjerimi i Rrjetit Mjekësor (tani edhe jashtë Shqipërisë)

Në funksion të zgjerimit të rrjetit mjekësor, gjatë vitit 2013, SiCRED ka nënshkruar disa marrëveshje të rëndësishme me spitale dhe klinika brenda dhe jashtë Shqipërisë.
Në korrik të vitit 2013, spitali SALUS u bë pjesë e rrjetit mjekësor SiCRED.
Në fund të vitit 2013, arritëm të nënshkruanim dy marrëveshje të rëndësishme me rrjete mjekësore përtej kufijve të Shqipërisë.
Një prej tyre është marrëveshja më spitalin Humanitas Gavazzeni në Bergamo të Italisë, një spital me një histori pothuaj 100 vjeçare, i njohur ndërkombëtarisht kryesisht për ndërhyrjet kardiovaskulare por edhe për shërbime të tjera mjekësore të standardeve më të mira.
Marrëveshja tjetër që arritëm të realizonim me sukses brenda vitit 2013, është marrëveshja me ofruesin e dytë më të madh në botë të shërbimeve mjekësore, Grupi Spitalor ACIBADEM në Turqi, një grup i integruar spitalor, i cili ofron shërbime edhe jashtë spitaleve dhe qendrave shëndetësore. Grupi Spitalor ACIBADEM, ofron diagnostikim dhe trajtim me cilësi të lartë në mjedise të sigurta e komforte për pacientët, përmes teknologjive mjekësore më bashkëkohore.
Përmes këtyre bashkëpunimeve, i kemi ofruar mundësinë të siguruarve të SiCRED, që të përfitojnë nga shërbimet mjekësore më cilësore si dhe teknologjive mjekësore bashkëkohore edhe jashtë Shqipërisë, duke gëzuar statusin “Klient i Privilegjuar”.

# 4 MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

**Të dhëna kyçe për burimet njerëzore të SiCRED (dhjetor 2013):**

| | |
|---|---|
| • Numri i punonjësve | 47 |
| • Mosha mesatare e punonjësve: | 36.45 vjeç |
| • Punonjëse Femra | 68% |
| • Punonjës Meshkuj | 32% |
| • Ditë totale Trajnimi | 130 dite |
| • Ditë trajnimi për punonjës | 2.8 dite |

Ne vlerësojmë punonjësit tanë si një avantazh konkurrues që kemi kundrejt konkurrentëve tanë, ndaj përpiqemi që edhe t'i trajtojmë ata si të tillë.

**Pikat kyçe të mirëmenaxhimit të burimeve njerëzore:**

1. **Rekrutim.** Procesin e rekrutimit të stafit, e konsiderojmë një nga proceset më të rëndësishme të menaxhimit të burimeve njerëzore, pasi synojmë që të bëjmë pjesë të stafit tonë, persona që jo vetëm profesionalisht përmbushin kërkesat kualifikuese të pozicionit të punës, por që shprehin pasion dhe përkushtim për punën e tyre.
2. **Trajnim.** Trajnimi i punonjësve është një proces me përfitime të shumëanshme, pasi ekzistenca e burimeve njerëzore të mirëtrajnuara është një nga pikat kyçe për arritjen e objektivave strategjike të grupit. Duke vlerësuar punonjësit tanë si asetin më të çmuar të grupit tonë, kujdesemi që ata të pajisen me njohuri të vazhdueshme në fushën e sigurimeve. Punonjësve tanë iu ofrohen trajnime të vazhdueshme çdo vit, brenda dhe jashtë Shqipërisë.
3. **Vlerësim.** Ne mendojmë që vetëm shpërblimi monetar, nuk është i mjaftueshëm për të treguar vlerësim dhe përkujdesje ndaj stafit tonë. Ndaj kemi ngritur një plan shpërblimesh monetare dhe jo-monetare, përmes të cilave synojmë të vlerësojmë, shpërblejmë, mbrojmë, kujdesemi në mënyrën më të mirë të mundshme për stafin tonë.
4. **Motivim.** Të punuarit duhet të jetë edhe kënaqësi për punonjësin. Kujdesemi që punonjësit tanë të kenë një ambient pune komod dhe miqësor, e ku përqafohet gjerësisht fryma e bashkëpunimit.
5. **Plan Karriere.** Mosha relativisht e re e punonjësve tanë, njëkohësisht edhe zgjerimi i vazhdueshëm i grupit, na ka orientuar në ndërtimin e planit të karrierës për stafin. Objektivi ynë është që punonjësit e talentuar dhe të përkushtuar të kenë një nxitje të vazhdueshme për të ecur përpara dhe sigurohemi që të përmbushim pritshmërinë e tyre për rritje profesionale.

**- TRAJNIME GJATË 2013**

Disa nga trajnimet që kanë ndjekur punonjësit e SiCRED, gjatë vitit 2013:





Trajnimi nga Scor Global Life në Paris, 12-18 Qershor 2013, me temë **"Product Development and Life Reinsurance".**





Trajnimi nga Scor Global Life në Zvicër, 7-11 Tetor 2013, me temë **"Expertise in Risks Assessment".**

Trajnimi nga IEF (Instituti i Ekspertëve Fiskal), për thellim të njohurive në: "Legjislacioni dhe sistemi fiskal në Republikën e Shqipërisë, legjislacioni doganor, Kontabiliteti, sistemi i informacionit dhe informatizimit financiar, analiza e pasqyrave financiare."

# 5 ZHVILLIMET KRYESORE GJATË 2013 SHOQËRIA ADMINISTRUESE E FONDIT TË PENSIONIT SICRED SH.A.

Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit SiCRED sh.a. është licensuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ("AMF") më 23.11.2011 për të ushtruar veprimtarinë e mbledhjes dhe investimit të fondeve të pensionit vullnetar si dhe në kryerjen e pagesave për pension. Ligji nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar", miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe rregulloret mbështetëse, të nxjerra nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare janë baza e aktiviteteve dhe operacioneve të Shoqërisë.
Shoqëria është një ndër tre shoqëritë që administrojnë fonde pensioni vullnetar në Shqipëri dhe ka aktualisht nën administrim një fond pensioni vullnetar, me emrin "SiCRED Pensions".

**Përse ekziston Fondi?**

Sigurimet Private si një formë efikase e ndërthurur me Sigurimet Shoqërore janë krijuar me synimin për të financuar të ardhurat në moshën e pensionit. Qëllimi i fondeve private të pensionit është sigurimi i të ardhurave suplementare për pension me qëllim që të sigurojë një nivel jetik më të lartë të individit kur ai arrin moshën e pensionit. Niveli i të ardhurave të individit pas daljes në pension do të përbëhet nga të ardhurat që ai siguron si rezultat i përfshirjes në Skemën e Sigurimeve Shoqërore të detyrueshme plus kontributin dhe përfitimet e nxjerra nga pjesëmarrja në Fondet Private të Pensionit.
Fondi i pensionit vullnetar është pjesë e njohur e sistemit ndërkombëtar të pensioneve. Ky lloj pensioni është krijuar për faktin se sistemet e zakonshme shtetërore të pensioneve nuk u sigurojnë njerëzve të ardhura të mjaftueshme kur arrijnë moshën e pensionit.

SiCRED Pensions kryen një menaxhim të plotë të aseteve sipas investimeve gjatë ciklit të jetës. Kjo lidhet ngushtë me misionin e shoqërisë i cili ka si objektiv ruajtjen e standardit të jetës edhe gjatë fazës së pensionit.
Shoqëria Administruese është e dedikuar të ndërtojë marrëdhënie afatgjatë me klientët që bazohet në 3 shtylla të forta:

**1)** Besueshmëria

**2)** Siguria

**3)** Transparenca


**Shoqëria synon të:**

- Inkurajojë anëtarësimin në Fond
- Rrisë ndërgjegjësimin në shoqëri për nevojën e pensioneve suplementare
- Sigurojë burimet e mjaftueshme për të përmbushur detyrimet
- Maksimizojë kthimin nga investimet brenda parametrave të përcaktuara të riskut
- Mundësojë kujdes maksimal ndaj klientit
- Përmirësojë shërbimin në mënyrë të vazhdueshme

**Ecuria e aktivitetit gjatë vitit 2013 dhe perspektiva për vitin 2014**

Viti 2013 ishte viti i dytë i aktivitetit të Shoqërisë dhe Fondit dhe për rrjedhojë drejtimi i Shoqërisë kishte fokus përveçse rritjes së klientëve, ngritjen e infrastrukturës së nevojshme dhe implementimin e sistemit elektronik të nevojshëm për të mundësuar kryerjen e aktiviteteve sipas kërkesave të ligjit dhe praktikave më të mira në menaxhimin e fondeve të pensionit vullnetar.
Më 1 Janar 2013 Fondi i Pensionit Vullnetar "SiCRED Pensions" kishte një numër prej 1,723 anëtarësh, ndërsa më 31 Dhjetor 2013 numri i anëtarëve arriti në 1,836, me një rritje neto prej 113 anëtarësh. Vlera Neto e Aseteve të Fondit më 31 Dhjetor 2011 ishte 21,103,673.79 Lekë, më 31 Dhjetor 2012 ishte 34,867,856.27 Lekë dhe më 31.12.2013 ishte 58,137,870.33 Lekë.
Pjesa më e madhe e portofolit të Fondit është e investuara në bono dhe obligacione të Shtetit Shqiptar.


**Alokimi i aseteve të Fondit më 31.12.2013 paraqitej si më poshtë:**




**Portofoli i Investimeve**

Vlera e aseteve për kuotë më 31 Dhjetor 2011 ishte 1,000.00 Lekë për kuotë, më 31.12.2012 arriti në 1,054.9538 Lekë për kuotë dhe më 31.12.2013 arriti më 1,121.5751 Lekë për kuotë. Norma mesatare e kthimit të portofolit të Fondit gjatë 2013-ës ka qenë 6.32%.

**Ecuria e çmimit për kuotë paraqitet si më poshtë deri më 31.12.2013:**




Gjatë vitit 2014 Shoqëria do të vazhdojë punën për ndërgjegjësimin e opinionit mbi domosdoshmërinë e investimit në fondet e pensionit vullnetar me synimin për të shtuar numrin e të anëtarësuarve në Fondin "SiCRED Pensions" dhe sidomos shtimin e skemave profesionale. Gjithashtu, Shoqëria do të ketë në fokus edhe shtimin e gamës së produkteve për t'iu përgjigjur sa më mirë kërkesave të klientëve.

# 6 ZHVILLIMET KRYESORE GJATË 2013 PËR SICRED ASSISTANCE

## I Kuadri i Përgjithshëm

Për SiCRED Assistance viti 2013, shënon vitin e zbatimit në praktikë të parimeve që justifikuan krijimin e këtij entiteti juridik. Nën këto kushte vështirësitë e bindjes së subjekteve për të përkrahur këtë politikë ligjore të plotësuar, përmirësuar dhe imponuar nga ligji në favor të kujdesit ndaj punëmarrësit, u identifikuan te "FRIKA", nëse këto shërbime ishin të domosdoshme për t'u realizuar nga entet punëdhënëse për punonjësit e tyre, derisa kostot ekonomike të realizimit të këtij shërbimi me kontratë rëndonin efektivisht mbi buxhetin e punëdhënësve. Sfida e SiCRED Assistance konsistoi në ndërgjegjësimin e subjekteve që përqafuan dhe kontraktuan këtë shërbim, se ishte bërë zgjidhja më e mirë për punëdhënësin dhe punëmarrësit, në raportet që këto dy segmente duale kanë të lidhura nga marrëdhëniet e punës.

Nën këto rrethana, dinamika e zhvillimeve politike të vitit 2013, e cila u identifikua edhe me ndryshime të karakterit thelbësor, në spektrin politik, rezultati i zgjedhjeve politike të zhvilluara në vend, solli në pushtet një tjetër forcë politike, e cila dhe në programin e saj elektoral proklamoi, si emergjencë trajtimin e punëmarrësve, mbi baza ligjore dhe formale dhe jo in-formale, shmangien në maksimum të çdo politike të zbatuar nga entet punëdhënëse me karakter antiligjor, apo në devijancë të ligjit, e lidhur drejtpërdrejtë apo indirekt me punëmarrësit, kujdesin për shëndetin dhe sigurinë e tyre në punë. Rritjen e efektivitetit të strukturave përgjegjëse shtetërore Inspektorati Shtetëror i Punës, Inspektorati i Shëndetit Publik, etj., për monitorim dhe imponim adekuat si dhe zbatim pa dallim të përcaktimeve ligjore në fuqi, që disiplinojnë marrëdhëniet e punës si dhe sigurinë dhe shëndetin në punë të punëmarrësve.

Pikërisht kjo frymë e programit qeverisës e prezantuar, publikisht rriti në një farë mënyre edhe sensibilitetin publik për, uljen e informalitetit, përmirësimin e praktikave ligjore që lidhen me aspektet e punës, si dhe forcimin e strukturave shtetërore përgjegjëse për zbatimin e masave për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Megjithëse në kuadër të aspiratës disa vjeçare të shtetit shqiptar për të qenë vend anëtar i Bashkimit Evropian (BE), është bërë punë e dukshme për përqasjen e legjislacionit, vërehet se është i vakët mjedisi për të përqafuar dhe zbatuar, nëpërmjet veprimeve konkrete masat e imponuara nga vetë ligji, lidhur me aspekte të sigurisë dhe shëndetit në punë. Është evident fakti që nga viti 2010, viti në të cilin hyri në fuqi Ligji Nr.10 237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", pasuar më vonë edhe me akte nënligjore për zbatim (VKM nr. 107, datë 09.02.2011, VKM nr. 108, datë 09.02.2011 dhe VKM nr. 562 datë 03.07.2013), vendi ynë ka bërë hapa pozitivë në këtë drejtim, përsa i përket kuadrit rregullator ligjor të sigurisë dhe shëndetit në punë. Pas disa vitesh vëzhgimi të problematikave të zbatimit të legjislacionit të punës, mund të themi me siguri që problemi në mjedisin shqiptar, qëndron në zbërthimin dhe aplikimin konkret të kërkesave ligjore nga entet që ju adresohet dhe imponohet zbatimi i legjislacionit të punës. Nëse tregojmë vëmendje ndaj të dhënave të publikuara nga Inspektorati Shtetëror i Punës, një problem i theksuar është mungesa në qendrat e punës e mjekut të punës, si dhe mungesa apo mosfunksionimi adekuat i këshillit të sigurisë.

**Vështirësitë aktuale të tregut të punës, për implementimin e legjislacionit të sigurisë dhe shëndetit në punë:**

**-Kuadri nënligjor i pa harmonizuar.** Megjithëse është bërë një hap i rëndësishëm, duke miratuar ligjin për sigurinë dhe shëndetin në punë si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, është evident fakti që nuk janë ende sendërtuar si duhet dhe harmonizuar udhëzuesit praktikë që plotësojnë me zbatim metodik parimet që ka vendosur ligji dhe aktet nënligjore për sigurinë dhe shëndetin në punë. Eksperienca e përftuar gjatë vitit 2013, identifikoi me qartë mangësitë për të pasur një proces të standardizuar dhe praktik për implementimin e ligjit dhe kërkesave të tij, po ashtu na detyroi të ndërtojmë procedura duke u munduar të transpozojmë, dhe përshtatim në varësi të specifikave kombëtare, akte që përdorin shoqëri homologe përtej kufijve, me më tepër eksperiencë praktikë ndër vite, derisa në tregun e këtushëm nuk mundëm të gjenim praktika të disiplinuara.

**- Mungesë informacioni** nga ana e punëdhënësve për detyrimet e tyre ligjore, si dhe mungesë koherence në zinxhirët përkatës monitorues shtetëror për ta bërë informacionin mbi sigurinë dhe shëndetin në punë një temë publike sensitive, që kërkon ndërgjegjësim publik, si për punëdhënësit dhe për punëmarrësit dhe për të drejtat dhe detyrimet që ata gëzojnë në lidhje me zbatimin e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë.

**- Vullnet i ulët i punëdhënësve** për zbatimin e ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë. Një mjedis pune i sigurt dhe i shëndetshëm, përkthehet në një sërë avantazhesh për punëdhënësin, si efiçencë më e lartë në punë, reduktim i kostove si pasojë

e aksidenteve, produkte dhe shërbime më cilësorë, etj., e pikërisht përkrahja e kësaj përqasjeje përgjithësish mungon në tregun e sotëm të punës.

**- Mungesa e konsulentëve të specializuar.** Ashtu si edhe në të gjithë botën, implementimi me sukses në vendin e punës i kërkesave ligjore për sigurinë dhe shëndetin në punë, nuk është një punë aq e thjeshtë. Shpesh bizneset nuk kanë kapacitete dhe burime të mjaftueshme njerëzore, për të përmbushur këto kërkesa, e ndaj lind nevoja e kontraktimit të shërbimeve të jashtme të specializuara. Aktualisht në Shqipëri janë vetëm 2 konsulentë të jashtëm për çështje të sigurisë dhe shëndetit në punë. Pavarësish eksperiencës dhe specifikave identifikuese, që bartin këto dy shoqëri vërejmë se në tërësi për çështje të sigurisë dhe shëndetit në punë, duhet thelluar edhe kuptimi dhe zbatimi praktik i parimeve të sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo ndër të tjera përbën edhe devizën e mbështetjes dhe zgjerimit të këtij aktiviteti, dhe për më tepër nga subjekte të posaçme që trajtojnë tërësisht dhe në mënyrë më të thelluar çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë.

# II Ecuria e aktivitetit gjatë 2013.

Gjatë vitit 2013 kemi lidhur kontratat e para të konsulencës me subjekte private, e tashmë iu shërbejmë më shumë se 700 punonjësve, duke i asistuar ata vazhdimisht në përmirësimin e praktikave për minimizimin e risqeve në vendet e punës, rritjen e eficiencë në punë, uljen e nivelit të stresit, etj.

# 7 OBJEKTIVAT PËR VITIN 2014

1) Mirëmenaxhim i kostove dhe shpenzimeve të përgjithshme, për t'i ulur ato me të paktën 5%. Duke shkurtuar shpenzimet e përgjithshme, apo duke ushtruar kontrolle më rigoroze për t'i mbajtur këto shpenzime në nivele sa më optimale, do kemi mundësi që të gjenerojmë fonde shtesë të cilat mund t'i përdorim në mënyrë më efektive, si në drejtim të inovacioneve dhe zhvillimit të produkteve të reja.

2) Fokusim drejt zhvillimit të paketave të sigurimit të shëndetit privat individuale dhe paketave familjare. Produktet tona të sigurimit janë kryesisht të fokusuara drejt bizneseve apo grupeve të mëdha. Gjatë vitit 2014 do punojmë për zhvillimin dhe ofrimin e produkteve për grupe më të vogla, e deri në krijimin e paketave të sigurimit të shëndetit individuale.

3) Zgjerim i kanaleve alternative të shpërndarjes dhe tregtimit të produkteve dhe shërbimeve të sigurimit. Një nga objektivat e vitit 2014 është gjithashtu forcimi i marrëdhënieve me institucionet partnere dhe zgjerimi i rrjetit për shitje ekskluzive.

4) Fillimi i ndërtimit të një strategjie për marketimin masiv dhe shitjen e produkteve të sigurimit të Jetës me elementë Kursimesh, si dhe duke luajtur një rol më aktiv në ndërgjegjësim e publikut. Kjo do të realizohet nëpërmjet krijimit të strukturave të posaçme e cilësorë të shitjeve.

5) Zgjerim i rrjetit mjekësor, me klinika dhe rrjete spitalore në vendet e Europës Perëndimore. Gjatë vitit 2014, objektivi ynë është të zgjerojmë sferën e bashkëpunimit me spitale dhe grupe spitalore dhe klinikash prestigjoze në Austri dhe të tjera në Itali.

# SiCRED sh.a.

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

(Me raportin e auditorit të pavarur bashkëlidhur)

# PËRMBAJTJA


Raporti i audituesit të pavarur

Pasqyrat financiare të konsoliduara:

- Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar 22
- Pasqyra e konsoluduar e të ardhurave përmbledhëse 23
- Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital 24
- Pasqyra e konsoliduar e fluksit të parasë 25
- Shënime mbi pasqyrat e konsoliduara financiare 26-53

# 8 RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

KPMG Albania Sh.p.k
"Dëshmorët e Kombit" Blvd
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524
+355(4)2274 534
Telefax +355(4)2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

## Raport i Audituesit të Pavarur

Aksionerëve të
Sicred Sh.A.

Tiranë, 20 Qershor 2014

Ne kemi audituar pasqyrat financiare e konsoliduara bashkëlidhur të Sicred Sh.a ("Shoqëria"), të cilat përbëhen nga pasqyra e konsoliduara te pozicionit financiar në datë 31 dhjetor 2013, dhe pasqyrat e konsoliduara fitim humbje dhe e të ardhurave te tjera përmbledhëse, pasqyrën e konsoliduara te ndryshimeve të kapitalit dhe të flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe shënime të tjera sqaruese.

*Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare te konsoliduara në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

*Përgjegjësia e Audituesve*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare te konsoliduara bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne t'u përmbahemi kërkesave etike të përshtatshme dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të fituar siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e proçedurave për të siguruar evidencë që mbështet shumat dhe informacionet shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura janë në varësi të gjykimit tonë, përfshirë këtu vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, prej gabimit apo mashtrimit. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, ne shqyrtojmë kontrollin e brendshëm, i cili është i rëndësishëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por që nuk kanë për qëllim shprehjen e një opinioni për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të njësisë ekonomike. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe të çmuarjeve të rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë eshtë e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

*Opinion*

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare te konsoliduara japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë për gjendjen financiare të konsoliduar të Shoqërisë me datë 31 dhjetor 2013, për rezultatet e saj financiare të konsoliduara dhe flukset e saj monetare të konsoliduara për vitin e mbyllur në atë datë, në pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Steven Nutley
*Partner*

KPMG Albania Sh.p.k.
"Dëshmorët e Kombit" Blvd.
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana
Albania

## SiCRED sh.a. Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2013

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

| AKTIVET | Shënime | 31 Dhjetor 2013 | 31 Dhjetor 2012 |
|---|---|---|---|
| Mjete monetare në arkë dhe në bankë | 9 | 8,461,235 | 12,938,503 |
| Depozita me afat | 10 | 583,335,464 | 533,733,970 |
| Investime në letra me vlerë | 11 | - | 15,270,009 |
| Aktive të risigurimit | 12 | 11,411,280 | 14,325,043 |
| Emër i mire | | 8,727,180 | 8,727,180 |
| Aktivet e trupëzuara, neto | 13 | 40,473,223 | 35,286,920 |
| Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi | 14 | 378,834,777 | 351,979,323 |
| Shpenzime të marrjes në sigurim të shtyra | | 7,944,104 | 3,532,926 |
| Të arkëtueshme nga Tatim Fitimi | | 5,005,116 | 12,192,433 |
| Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura | 15 | 5,492,402 | 5,143,902 |
| Aktive të tjera | 16 | 14,848,343 | 6,451,255 |
| Të arkëtueshme nga Fondi | | 144,094 | 79,514 |
| **TOTALI I AKTIVEVE** | | **1,064,677,218** | **999,660,978** |
| **DETYRIMET** | | | |
| Detyrimet për humbjen dhe rregullimi i shpenzimeve për humbjen | 17 | 11,175,873 | 5,481,534 |
| Rezerva për primin e pafituar | 18 | 112,177,772 | 97,207,896 |
| Rezerva të tjera | 19 | 82,278,052 | 65,377,114 |
| Të ardhura të periudhave të ardhshme | 14 | 317,439,691 | 268,088,844 |
| Llogari të pagueshme sigurimi dhe risigurimi | 14 | 693,106 | 5,279,438 |
| Detyrime ndaj institucioneve financiare | 20 | 13,908,502 | 26,415,485 |
| Detyrime të tjera | 21 | 22,990,574 | 22,803,008 |
| **Totali i Detyrimeve** | | **560,663,570** | **490,653,319** |
| **KAPITALI** | | | |
| Kapitali i paguar | 22 | 473,300,000 | 405,500,000 |
| Kapital i nënshkruar, i paguar por i parregjistruar | 22 | 3,700,000 | 67,800,000 |
| Rezerva ligjore | 22 | 1,916,149 | 1,916,149 |
| Rezerva sigurimi | 22 | 32,171,203 | 31,363,539 |
| Fitime të akumuluara | | (11,219,158) | (3,980,673) |
| Totali i kapitalit i kredituar te pronaret | | 499,868,194 | 502,599,015 |
| Interesi jo-kontrollues | 8 | 4,145,454 | 6,408,644 |
| Totali kapitalit | | 504,013,648 | 509,007,659 |
| **TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALI** | | **1,064,677,218** | **999,660,978** |

*Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i SiCRED sh.a. më 20 Qershor, 2014 dhe janë firmosur nga*

**Genc Koxhaj**

*Drejtor i Përgjithshëm*




**Teuta Locaj**

*Dr.Dep.Fin.&Kontabilitet*



*Shënimet shoqëruese në faqet 6 deri 36 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave të konsoliduara financiare.*

## SiCRED sh.a. Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

| | Shënime | 2013 | 2012 |
|---|---|---|---|
| Të ardhura nga primet e shkruara bruto | 23 | 220,765,611 | 207,263,993 |
| Prime të shkruara ceduar risiguruesit | 24 | (14,857,305) | (16,768,337) |
| **Prime të shkruara neto** | | **205,908,306** | **190,495,656** |
| | | | |
| Ndryshimi neto në rezervën e primeve të pafituara | 18 | (14,969,876) | (22,471,363) |
| Ndryshimi neto në rezerva të tjera | 19 | (16,900,936) | (17,200,777) |
| Ndryshimi neto në rezervën e risiguruesit | 12 | (2,913,763) | 1,146,642 |
| Ndryshimi neto në shpenzime të shtyra | | 4,411,178 | 919,369 |
| **Të ardhura neto nga primi i sigurimit** | | **175,534,909** | **152,889,527** |
| | | | |
| Të ardhura financiare | 25 | 30,883,176 | 29,764,530 |
| Shpenzime financiare | 25 | (1,621,582) | (1,049,861) |
| Fitime/(humbje) nga kurset e këmbimit | 25 | (1,180,568) | (822,259) |
| Të ardhura nga tarifa e menaxhimit | | 1,364,420 | 706,728 |
| Të ardhura të tjera operative | | 11,569,924 | 12,537,905 |
| **Totali i të ardhurave** | | **216,550,279** | **194,026,570** |
| | | | |
| Dëme të ndodhura të sigurimit | 17 | (27,974,118) | (22,947,540) |
| Kostot e marrjes në sigurim | 26 | (60,375,988) | (51,853,096) |
| Shpenzime administrative | 27 | (124,298,340) | (117,909,066) |
| Amortizimi | 13 | (8,298,525) | (6,133,696) |
| **Totali i të ardhurave** | | **(220,946,971)** | **(198,843,398)** |
| | | | |
| (Humbje)/Fitimi para tatimit | | (4,396,692) | (4,816,828) |
| | | | |
| **Tatimi mbi fitimin** | **28** | **(945,820)** | **(1,070,580)** |
| | | | |
| (Humbja)/ Fitimi i vitit | | (5,342,512) | (5,887,408) |
| | | | |
| **Të ardhura të tjera përmbledhëse** | | - | - |
| | | | |
| **Totali i të (humbjeve)/ardhurave përmbledhëse të vitit** | | **(5,342,512)** | **(5,887,408)** |
| (Humbja)/Fitimi i kredituar tek: | | | |
| Pronarët e Shoqërisë | | (3,836,970) | (3,366,460) |
| Interesi jo-kontrollues | | (1,505,542) | (2,520,948) |
| (Humbja)/Fitimi i vitit | | (5,342,512) | (5,887,408) |
| | | | |
| Totali i të ardhurave përmbledhëse i kredituar tek: | | | |
| Pronarët e Shoqërisë | | (3,836,970) | (3,366,460) |
| Interesi jo-kontrollues | | (1,505,542) | (2,520,948) |
| **Totali i (humbjeve)/të ardhurave përmbledhëse për vitin** | | **(5,342,512)** | **(5,887,408)** |

*Shënimet shoqëruese në faqet 6 deri 36 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave të konsoliduara financiare.*

## SiCRED sh.a. Pasqyra e konsoliduar e lëvizjeve të kapitalit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

| | Kapitali i paguar | Kapitali i paguar, i parregjistruar | Rezerva ligjore | Rezerva të tjera | Fitim i akumuluar | Totali | Interesa jo-kontrollues | Totali Kapitalit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Gjendja me 1 janar 2012 | 405,500,000 | - | 1,916,149 | 25,425,569 | 77,023,757 | 509,865,475 | 3,927,592 | 513,793,067 |
| | | | | | | | | |
| Humbja e vitit | - | - | - | - | (3,366,460) | (3,366,460) | (2,520,948) | (5,887,408) |
| Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatimi | - | - | - | - | - | - | - | - |
| **Totali i të ardhurave përmbledhëse për periudhën** | **-** | **-** | **-** | **-** | **(3,366,460)** | **(3,366,460)** | **(2,520,948)** | **(5,887,408)** |
| **Transaksione me pronarët, të rregjistruara direkt në capital** | | | | | | | | |
| Rritje në kapitalin e paguar | - | 67,800,000 | - | - | (67,800,000) | - | - | - |
| Rritje në rezerva të tjera | - | - | - | 5,937,970 | (5,937,970) | - | - | - |
| Dividendë të paguar | - | - | - | - | (3,900,000) | (3,900,000) | - | (3,900,000) |
| **Interesi jo-kontrollues** | | | | | | | | |
| Interesi jo-kontrollues | - | - | - | - | - | - | 5,002,000 | 5,002,000 |
| **Totali i transaksioneve me pronarët e Shoqërisë** | **-** | **67,800,000** | **-** | **5,937,970** | **(77,637,970)** | **(3,900,000)** | **5,002,000** | **1,102,000** |
| **Gjendja e riparaqitur më 31 dhjetor 2012** | **405,500,000** | **67,800,000** | **1,916,149** | **31,363,539** | **(3,980,673)** | **502,599,015** | **6,408,644** | **509,007,659** |
| Humbja e vitit | - | - | - | - | (3,836,970) | (3,836,970) | (1,505,542) | (5,342,512) |
| Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatimi | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Totali të ardhurave përmbledhëse për periudhën | - | - | - | - | (3,836,970) | (3,836,970) | (1,505,542) | (5,342,512) |
| **Transaksionet me pronarët, të njohura në capital** | | | | | | | | |
| Rregjistrimi i kapitalit | 67,800,000 | (67,800,000) | - | - | - | - | - | - |
| Rritje në kapitalin e paguar dhe rezerva të tjera | - | 3,700,000 | - | 807,664 | (4,507,664) | - | - | - |
| Blerje e interest jo-kontrollues pa ndryshim kontrolli | - | - | - | - | 1,106,149 | 1,106,149 | (757,648) | 348,501 |
| **Totali transaksioneve me pronarët e Shoqërisë** | **67,800,000** | **(64,100,000)** | **-** | **807,664** | **(3,401,515)** | **1,106,149** | **(757,648)** | **348,501** |
| **Gjendja më 31 dhjetor 2013** | **473,300,000** | **3,700,000** | **1,916,149** | **32,171,203** | **(11,219,158)** | **499,868,194** | **4,145,454** | **504,013,648** |

*Shënimet shoqëruese në faqet 6 deri 36 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave të konsoliduara financiare.*

## SiCRED sh.a. Pasqyra e konsoliduar e fluksit të parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

| | Shënime | 2013 | 2012 |
|---|---|---|---|
| Fluksi i parasë nga aktivitetet operative | | | |
| (Humbja)/Fitimi neto për vitin | | (4,396,692) | (4,816,828) |
| Rregullime për: | | | |
| Amortizimin | 13 | 8,298,525 | 6,133,696 |
| Nxjerrje jashtë përdorimi të aktiveve të qëndrueshme | 13 | 452,388 | 1,491,589 |
| Ndryshimi në rezervën për primet e pafituara | 18 | 14,969,876 | 22,471,363 |
| Ndryshimi në rezervën e risigurimit | 12 | 2,913,763 | (1,146,642) |
| Ndryshimi në rezerva të tjera | 19 | 16,900,936 | 17,200,775 |
| Ndryshimi në humbje dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve | 17 | 5,694,339 | (603,095) |
| Provigjione | 14 | - | 31,040 |
| Shpenzime interesi | 25 | 1,621,582 | 1,049,861 |
| Të ardhura nga interesi | 25 | (30,883,176) | (29,764,530) |
| Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operative: | | | |
| Ndryshimi në shpenzimet e shtyra | | (4,411,178) | (919,369) |
| Ndryshimi në të ardhurat e shtyra të periudhave të ardhshme | 14 | 49,350,847 | 102,389,341 |
| Ndryshimi në llogaritë e arkëtueshme të sigurimit dhe risigurimit | 14 | (26,855,454) | (119,069,565) |
| Ndryshimi në aktivet e tjera | | (8,397,088) | (831,453) |
| Ndryshimi në të arkëtueshme nga Fondi | | (64,580) | 894,293 |
| Ndryshimi në mjetet monetare të kushtëzuara | | 394,109 | (196,110) |
| Ndryshimi në llogari të pagueshme të sigurimit dhe risigurimit | 14 | (4,586,332) | (652,887) |
| Ndryshimi në detyrime të tjera | | 187,567 | 3,626,875 |
| Ndryshimi në taksa të arkëtueshme | | 7,187,317 | (1,491,213) |
| Ndryshimi i të arkëtueshme nga palët e lidhura | | (348,501) | (5,002,000) |
| Interes i arkëtuar | | 1,515,980 | 30,509,009 |
| Interes i paguar | | (1,621,582) | (1,049,861) |
| Tatim fitimi i paguar | | (945,820) | (1,070,579) |
| **Flukset monetare të gjeneruara nga operacionet** | | **56,976,826** | **19,183,710** |
| | | | |
| Flukset monetare nga aktivitetet investuese | | | |
| Blerja e aktiveve të trupëzuara | 13 | (13,937,216) | (19,280,158) |
| Rritja në depozita me afat | 10 | (49,942,193) | (14,101,210) |
| Ndryshimi në investimin e letrave me vlerë | 11 | 14,977,906 | (14,977,906) |
| **Flukset monetare për aktivitetet investuese** | | **(48,901,503)** | **(48,359,274)** |
| | | | |
| Flukset monetare të përdorura në aktivitetet financuese | | | |
| Shpërndarje dividendësh | 22 | - | (3,900,000) |
| Hua | 20 | (12,506,983) | 26,415,485 |
| Të ardhurat nga rritjet e kapitalit pas blerjes për interesin jo-kontrollues | | 348,501 | 5,002,000 |
| **Flukset monetare të përdorura në aktivitetet financuese** | | **(12,158,482)** | **27,517,485** |
| | | | |
| Rritje/(rënie) neto për mjetet monetare dhe ekuivalente | | (4,083,159) | (1,658,079) |
| Mjete monetare dhe ekuivalentë në fillim të vitit | | 12,544,394 | 14,202,473 |
| **Mjete monetare dhe ekuivalentë në fund të vitit** | | **8,461,235** | **12,544,394** |

*Shënimet shoqëruese në faqet 6 deri 36 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave të konsoliduara financiare.*

**SiCRED sh.a. Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**
(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

# 1. TË PËRGJITHSHME

SiCRED sh.a ("Shoqëria") u krijua më 7 Tetor 2003 si një Shoqëri Sigurimi Jete me vendndodhje në Shqipëri. Shoqëria u licensua nga Autoriteti Mbikqyrës i Sigurimeve dhe filloi aktivitetin e saj të sigurimit më 1 tetor 2004. Shoqëria ka degë të vendosura kryesisht në Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Gjirokastër, Elbasan, dhe Korçë. Tregu i Sigurimeve në Shqipëri është i rregulluar me anë të ligjit nr. 9267 datë 29.07.2004 "Mbi aktivitetin e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetsimit në sigurim dhe risigurim" të Republikës së Shqipërisë ("Ligji i Sigurimit") dhe njësia rregullatore Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare ("Autoriteti").
Më 1 Shkurt 2011, Shoqëria bleu 75% të aksioneve të Sigma IPP në pronësi të Sigma Vig. Transferimi i aksioneve është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 24 Maj 2011. Në datë 14 Qershor 2011, në Mbledhjen e Asamblesë së Aksionerëve , u vendos ndryshimi i emrit të filialit nga "Instituti Privat Sigma IPP" në "Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit SiCRED sh.a" (Filiali). Filiali vepron si shoqëri administruese e fondeve të pensionit vullnetar, në mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensionit vullnetar dhe kryerjen e pagesave të pensionit. Më 13 Dhjetor 2011, Autoriteti, bazuar në Vendimin Nr. 173, miratoi "Fondi i Pensionit Vullnetar SiCRED Pensions" nën administrimin e Filialit, i cili duke mos patur një formë ligjore, mori licencën nga AMF më 21 dhjetor 2011. Gjatë 2013, një strukturë e re e kapitalit të paguar u aprovua për "Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit SiCRED sha", në të cilën kapitali i SiCred u rrit nga 75% në 87.25% më 31.12.2013.
Më 29 Qershor 2012 në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionerëve u vendos themelimi i SiCRED Assistance i cili është plotësisht pronë e Shoqërisë. Objektivi i tij është t'u sigurojë asistencë dhe shërbime konsulence kompanive për implementimin e legjislacionit dhe rregullave teknike për të siguruar mirëqenien e punonjësve, si dhe sigurimin e asistencës dhe konsulencës për të analizuar, identifikuar dhe për të parandaluar rreziqet në vendin e punës, në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës.
Pasqyrat Financiare të konsoliduara përfshijnë Shoqërinë dhe Filialin (së bashku të referuara si "Grupi"). Më 31 Dhjetor 2013, Grupi kishte të punësuar 58 punonjës dhe personel drejtues (2012: 58).

# 2. BAZAT E PËRGATITJES

**a) Baza e Përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

**b) Baza e përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të kostos historike.

**c) Monedha funksionale dhe e prezantimit**

Këto pasqyra financiare janë të prezantuara në Lek, që është dhe monedha funksionale e Grupit. Përveç rasteve ku specifikohet ndryshe, informacioni financiar është i prezantuar në Lek.

**d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimit**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtuesit të kryejnë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktivëve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësimeve. Vlerësimet dhe bazat e llogaritjes rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimet rishikohen dhe për periudhat e ardhshme të cilat ndikohen. Në veçanti, informacioni rreth fushave më kryesore për llogaritjen e pasigurisë dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare përshkruhen në shënimet 17, 18 dhe 19.
Politikat kontabël të vendosura më poshtë janë aplikuar në përputhje me të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare dhe janë aplikuar me konsistencë nga Grupi.

# 3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare dhe janë aplikuar në mënyrë konsistente nga Grupi.

## a) Bazat e konsolidimit

### (i) Kombinimi i biznesit

Kombinimet e biznesit kontabilizohen duke përdorur metodën e blerjes në datën e blerjes, e cila është data në të cilën kontrolli i është transferuar Grupit. Kontrolli është fuqia për të qeverisur politikat financiare dhe operative të një njësie ekonomike në mënyrë që të marrë përfitime nga aktivitetet e saj. Në vlerësimin e kontrollit, Grupi i merr në konsideratë të drejtat të mundshme të votës që aktualisht mund të ushtrohen. Grupi mat emrin e mirë në datën e blerjes, si:

- vlera e drejtë e shumës së transferuar; plus
- shuma e njohur për çdo interes jo-kontrollues të blerësit; plus
- shuma neto e njohur (në përgjithësi vlera e drejtë) të aktiveve të identifikueshme të blera dhe pasivet e marra.

Kur teprica është negative, një fitim në blerje njihet menjëherë në fitim ose humbje. Kostot e transaksionit, përveç atyre që lidhen me emetimin e letrave me vlere të borxhit dhe letrave me vlere të kapitalit neto, që Grupi ka në lidhje me një kombinim biznesi shpenzohen kur ato ndodhin.
Çdo shumë e kushtëzuar e pagueshme matet me vlerën e drejtë në datën e blerjes. Nëse shuma e kushtëzuar është klasifikuar si kapital, atëherë ajo nuk rimatet dhe shlyerja kontabilizohet në kapital. Përndryshe, ndryshimet e mëvonshme në vlerën e drejtë të shumës së kushtëzuar njihen në fitim ose humbje.

### (ii) Filialet

Filialet janë subjekte të kontrolluara nga Grupi. Pasqyrat financiare të filialeve janë të përfshira në pasqyrat financiare të konsoliduara nga data e fillimit të kontrollit deri në datën që kontrolli mbaron.

### (iii) Transaksionet që eliminohen në konsolidim

Gjëndjet dhe transaksionet brenda grupit, dhe të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e parealizuara që lindin nga transaksionet brenda grupit, janë eliminuar në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara. Fitimet e parealizuara që vijnë nga transaksionet me kapitalin e filialit janë eliminuar në masën e interesit që Grupi ka tek filiali. Humbjet e parealizuara janë eliminuar në të njëjtën mënyrë si fitimet e parealizuara, por vetëm në masën që nuk ka evidenca për zhvlerësim.

## b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale të Grupit sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare të regjistruara në monedha të huaja në datën e raportimit, këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së raportimit. Fitimi ose humbja që vjen nga këmbimet valutore të aktiveve monetare, është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të vitit, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë vitit, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të këmbyer me kursin e këmbimit në fund të vitit.
Aktivet dhe detyrimet jo-monetare të regjistruara në monedhë të huaj që maten me vlerën e drejtë, rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është caktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetare të regjistruara në monedhë të huaj që maten me kosto historike, këmbehen me kursin e këmbimit në datën kur kryhet transaksioni.

## c) Klasifikimi i kontratave të sigurimit dhe investimeve

Kontrata nën të cilat Grupi pranon të marrë një rrezik të rëndësishëm nga një palë tjetër (policë-mbajtësi) duke rënë dakort të kompensojë policë-mbajtësin për një ngjarje të caktuar të pasigurtë (ngjarja siguruese) e cila ka efekte negative dhe ndikon në policë-mbajtësin, janë klasifikuar si kontrata sigurimi. Rreziku i sigurimit është një rrezik ndryshe nga rreziku financiar. Rreziku financiar  është rreziku i ndryshimeve të mundshme të ardhshme në një ose në disa norma interesi specifike, çmimet e letrave me vlerë, kursi i këmbimit, indekset e çmimeve ose të normave, normat e kreditimit apo indekset e kreditimit ose variabla të tjerë, të siguruar në rastin e variablave jo-financiarë kur variabli nuk është specifik për një palë në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë një pjesë të rrezikut financiar.

## d) Njohja dhe matja e kontratave

### PRIMET

**Primet për sigurimin e jetës**

Primet e shkruara bruto përfshijnë detyrimet për shumat gjatë vitit financiar në përputhje me sigurimin direkt, pavarësisht nëse keto shuma lidhen pjesërisht ose plotësisht me periudhat e mëvonshme kontabël. Primet paraqiten bruto nga komisionet e pagueshme ndaj ndërmjetësve dhe paraqiten neto nga taksat e pagueshme mbi to. Pjesa e fituar e primeve njihet si e ardhur.

Primet fitohen që nga momenti i lidhjes me rrezikun përgjatë gjithë periudhës së mbuluar në bazë të modelit të rrezikut të marrë përsipër. Primet për risigurim njihen si shpenzime në përputhje me modelin e shërbimit të risigurimit të përfituar. Nëse një policë është anulluar primi i mbetur për tu paguar zbritet nga të ardhurat nga primet.
Lëvizjet e detyrimeve të sigurimit njihen si të ardhura neto nga pjesa e risiguruesit, nëse ka. Të ardhurat nga investimet në letra me vlerë paraqiten bruto. Të ardhurat nga interesi i depozitave me afat dhe investimet në letra me vlerë është bërë mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuar në bazë të metodës së interesit efektiv.

**Rezerva për primin e pafituar**
Primet e pafituara janë llogaritur në përputhje me pagesat individuale të rinovueshme të biznesit. Ato paraqesin atë pjesë të primeve të shkruara bruto e cila lidhet me mbulimin e sigurimit nga polica e lëshuar nga Grupi, e cila zgjatet në periudhat e ardhshme mbi datën e raportimit.

**Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim**
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim janë shumat e kostove të blerjes të cilat zbriten kur llogaritet rezerva për primin e pafituar. Ato janë përcaktuar si pjesë e kostove të blerjes si përqindje e planit të sigurimit teknik dhe lidhen me periudha midis fundit të periudhës raportuese dhe datës së përfundimit të kontratës së sigurimit. Kostot aktuale të blerjes njihen plotësisht si shpenzim në periudhën aktuale.

## DËMET

**Dëmet për sigurimin e jetës**
Dëmet e lindura përbëhen nga pagesat e bëra gjatë vitit financiar së bashku me ndryshimin në provigjion për dëmet e ndodhura gjatë vitit. Dëmet bruto të paguara përfshijë të gjithë shpenzimet e bëra për këto dëme, të cilat llogariten duke përdorur metodat e trekëndëshit.

**Provigjionet për dëmet**
Provigjionet për dëmet janë shumat e të gjitha dëmeve që kanë lindur gjatë periudhës financiare aktuale dhe të mëparëshme të cilat nuk janë paguar në përfundim të vitit fiskal. Provigjioni përfshin dëmet e ndodhura ,por të paraportuara, llogaritur si përqindje mbi dëmet e ndodhura por jo të shlyera duke u bazuar në treg dhe historinë e periudhave të mëparshme të grupit.

**Biznesi afatgjatë (Rezerva të tjera)**
Rezervat e biznesit afatgjatë lidhen me produktin e Jetës me Kursim dhe matet si shuma e plotë e fondit të akumuluar në datën e raportimit.

## RISIGURIMI

Grupi cedon risigurimin në rrjedhën normale të biznesit me qëllin që të limitojë humbjen neto nëpërmjet diversifikimit të rrezikut. Marrëveshjet e risigurimit nuk i heqin Grupit detyrimet ndaj policëmbajtësve. Primet e ceduara dhe përfitimet e rimbursimit paraqiten në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse dhe pasqyrën e pozicionit financiar me baza bruto. Kontratat nga të cilat lind një transferim i rrezikut të sigurimit kontabilizohen si sigurim. Shumat e rigjeneruara nga këto kontrata njihen në të njëjtin vit me dëmin. Aktivet e risiguruara përfshijnë balanca detyrimi nga shoqëria risiguruese për detyrimet e primeve të ceduara.
Shumat e rigjeneruara nga risiguruesi llogariten në mënyrë konsistente me provigjionin e dëmeve ose dëmet e vendosura të lidhura me policën e risiguruar.
Shumat e rigjeneruara nën kontratat e risigurimit llogariten për zhvlerësim në çdo datë. Këto aktive zhvlerësohen nëse ka evidencë objektive, si pasojë e një ngjarje që ka lindur pas njohjes fillestare, për të cilat Grupi nuk mund të rimarrë të gjitha shumat që i detyrohen dhe për një ngjarje e cila ka një impakt të matur në mënyrë të besueshme për shumat të cilat Grupi do të marrë nga risiguruesi.

**Testi i mjaftueshmërisë së rezervës**
Në çdo datë raportimi Grupi bën një test të mjaftueshmërisë së rezervës i cili i jep Grupit një vlerësim nëse detyrimet e sigurimit të cilat janë njohur janë të mjaftueshme. Gjithashtu, testet e kryera përfshijnë Analizën e Raportit të Dëmeve dhe Analizën e Zhvillimit të provigjioneve të dëmeve.
Analiza e raportit të dëmeve kryhet çdo vit individualisht për të gjitha produktet kryesore të biznesit nga Grupi. Llogaritja bëhet vetëm mbi dëmet, si dhe mbi dëmet duke përfshirë kostot e blerjes dhe ndonjë kosto tjetër të jashtme si kostoja e mirëmbajtjes. Për të kryer këtë analize, Grupi merr parasysh parashikimet për daljet e flukseve të parave. Grupi nuk i skonton këto flukse parash sepse shumica e dëmeve priten te shlyhen brenda vitit.
Gjithashtu, Grupi bën edhe Analizën e Zhvillimit të provigjionve të dëmeve për të vlerësuar metodologjinë e saj të përcaktimit të rezervave. Kjo analize kryhet në mënyrë të veçantë ,por dhe të kombinuar për RBNS (të raportuara ,por ende të pambyllura) dhe IBNR (të ndodhura por të paraportuara). Nëse analiza nxjerr në pah mospërputhje të mëdha, Grupi kryen rregullime në

metodologjinë e përdorur. Nëse identifikohet një mungesë ajo ngarkohet menjëherë në fitim ose humbje duke krijuar një provigjion për rrezikun e paskaduar nga humbjet që dalin nga testi i mjaftueshmerisë së rezervës.

## e) Të ardhura nga investimet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat e investimeve njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në bazë të metodës së interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skonton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së aktivit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme një periudhë më e shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të aktivit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset në momentin fillestar të njohjes së aktivit, ose detyrimit financiar dhe nuk ndryshohet në periudhat e mëtejshme.
Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra, kostot e transaksionit, zbritjeve, primeve të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit janë kosto shtesë të lidhura me blerjen, emetimin ose ç'rregjistrimin e aktivit, ose detyrimit financiar. Të ardhurat nga investimet të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave pasqyrojnë interesin e aktiveve financiare të investuara të Grupit.

## f) Instrumentat financiarë

### (i) Njohja

Grupi fillimisht njeh kreditë dhe depozitat në datën kur lindin të drejtat dhe detyrimet përkatëse. Të gjitha detyrimet dhe aktivet financiare njihen në datën e transaksionit sipas së cilit Grupi bëhet palë e detyrimeve kontraktore të instrumentit.

### (ii) Klasifikimi

Shiko politikat kontabël 3(g) and (h).

### (iii) Ç'regjistrimi

Grupi ç'regjistron një aktiv financiar nëse humbet kontrollin mbi flukset e ardhshme të parasë ose
transferon të drejtat për të marrë flukset kontraktuale të parasë nga aktivet financiare në transaksione në të cilat i gjithë rreziku dhe përfitimet nga aktivet financiare është transferuar. Çdo interes nga aktivi financiar i transferuar që është krijuar ose mbajtur nga Grupi njihet si aktiv ose detyrim i veçantë. Grupi ç'regjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shuhen, anullohen ose maturohen.

### (iv) Netimi

Aktivet dhe detyrimet financiare mund të netohen dhe tepricat neto të paraqiten në bilanc vetëm kur Grupi ka të drejta ligjore për të netuar shumat dhe ka qëllim të arkëtojë ose të mbylli aktivin apo detyrimin neto në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten të netuara kur lejohet nga standartet e kontabilitetit, ose për fitime dhe humbje që lindin nga transaksione me natyrë të njëjtë si në aktivitetin tregtar të Grupit.

### (v) Matja me kosto të amortizuar

Kosto e amortizuar e një aktivi financiar është vlera me të cilën aktivi financiar ose detyrimi financiar është matur në njohjen fillestare, duke zbritur këstet e paguara, plus ose minus amortizimin kumulativ që rezulton nga përdorimi i metodës së interesit efektiv duke marrë parasysh ndonjë diferencë midis vlerës së njohur në fillim dhe vlerës në maturim si dhe humbjet nga rënia në vlerë.

### (vi) Matja me vlerë të drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është bazuar në çmimet e publikuara të tregut dhe treguesve të instrumentave financiare në tregjet aktive. Për të gjitha instrumentat financiare të tjerë vlera e drejtë është përcaktuar duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknika të tilla si vlera reale neto, metoda e aktualizimit të flukseve, krahasimi me instrumenta të tjerë të ngjashëm për të cilat çmimet përcaktohen në tregje aktive, si dhe modele të tjera vlerësimi.

### (vii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë

Në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare Grupi vlerëson nëse ka evidenca objektive për rënien në vlerë të aktiveve financiare. Aktivet financiare pësojnë rënie në vlerë kur evidenca objektive dëshmon që një ngjarje me pasojë humbje ka ndodhur pas vlerësimit të mëparshëm të aktivit, si dhe kjo ngjarje ndikon në flukset e mjeteve monetare të vlerësueshme në mënyrë të besueshme. Grupi merr në konsideratë evidenca për rënien në vlerë të aktiveve financiare specifike ose në grup të aktiveve. Të

gjitha aktivet individualisht të rëndësishme testohen veçmas për humbjen e mundshme në vlerë ,por që nuk është identifikuar ende. Të gjitha aktivet që nuk konsiderohen të jenë individualisht të rëndësishëm grupohen dhe vlerësohen duke grupuar aktivet financiare me karakterisitika të njëjta risku (të mbajtura me kosto të amortizuar) për rënie në vlerë.

Si evidencë objektive për rënie në vlerë të mundshme të aktiveve në pasqyrat financiare mund të përmendet mosshlyerja në kohë apo shkelja e termave nga një debitor, ristrukturimi i një kredie/paradhënie të dhënë nga Grupi me terma të cilat në kushte të tjera nuk do të ishin konsideruar, tregues për falimentimin e mundshëm të një debitori ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si ndryshimi në përkeqësim në statusin e arkëtueshmërisë së një debitori ose kreditori, apo kushte ekonomike që lidhen me përkeqësimin e Grupit.

## g) Mjete monetare dhe ekuivalentë me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to përfshijnë balancat e gjëndjes në arkë, mjetet monetare të depozituara në banka të nivelit të dytë dhe investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe me maturitet deri në tre muaj ose më pak që nga momenti i blerjes.

## h) Depozitat me afat

Depozitat me afat paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar me shumën e principalit të tyre dhe klasifikohen ato depozita me maturitetit më të madh se tre muaj. Interesi llogaritet në bazë të detyrimeve dhe të drejtave të konstatuara dhe interesi i arkëtueshëm pasqyrohet në llogaritë e tjera të arkëtueshme.

## i) Letrat me vlerë

Letrat me vlerë janë investime borxhi të cilat Grupi ka për qëllim dhe aftësi t'i mbajë deri në maturim dhe që janë klasifikuar si aktive të mbajtura deri në maturim. Investimet të cilat kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe të cilat synohen të mbahen deri në maturim dhe si rrjedhim maten me kosto të amortizuar, minus provigjionin për rënien në vlerë. Kosto e amortizimit llogaritet duke marrë në konsideratë ndonjë skontim ose prim në blerje. Primet dhe skontimet në investimet e projektuara si të mbajtura deri në maturim amortizohen sistematikisht gjatë maturitetit duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe rregjistrohen si të ardhura nga interesi.

## j) Ndërtesa dhe pajisje

### (i) Njohja dhe matja

Zërat e ndërtesës dhe paisjeve (ose aktivet e qëndrueshme të trupëzuara) maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzime të cilat lidhen direkt me koston e blerjes së aktiveve. Kostoja e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe punën direkte, çdo kosto tjetër që lidhet me vënien e aktivit në punë, dhe kostot e rregullimit të vëndit në në të cilin ato do të vendosen. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë integrale e funksionimit të paisjes kapitalizohet si pjesë e paisjes. Kur pjesë të një zëri të ndërtesës ose paisjeve kanë jetëgjatësi të ndryshme ato kontabilizohen si zëra të ndarë (përbërësit kryesor) të ndërtesës dhe paisjeve.

### (ii) Kostot e mëvonshme

Në vlerën e mbartur të një njësie të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara Grupi njeh kostot e zëvëndësimit të një pjese të kësaj njësie kur ka ndodhur kjo kosto, në qoftë se është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara tek njësia t'i shkojnë Grupit dhe kostoja e njësisë të mund të matet me besueshmëri. Të gjitha kostot e tjera njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si një shpenzim në momentin që ndodh.

### (iii)Amortizimi

Amortizimi njihet në fitim dhe humbje me metodën e vlerës së mbetur mbi jetëgjatësinë e llogaritur të aktiveve. Aktive me qera financiare amortizohen me vlerën më të vogël të afatit të qerasë financiare dhe jetës së përdorimit. Veprat e artit nuk amortizohen. Normat e vlerësuara të zhvlerësimit janë si më poshtë:

| | |
|---|---|
| Ndërtesa (Kioska) | 5% |
| Mobilje dhe paisje zyrash | 20% |
| Kompjutera | 25% |
| Mjete transporti | 20% |
| Installime kompjuterike | 25% |

| | |
|---|---|
| Përmirësime në ambientet e marra me qera | Sipas termave të kontratës së qerasë |

## k) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Grupit, përveç aktiveve me tatime të shtyra, shqyrtohet në çdo datë bilanci për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë tregues për rënie në vlerë të aktivit. Në qoftë se ekziston ndonjë tregues i tillë, vlera kontabël vlerësohet.
Një humbje nga rënia në vlerë njihet kurdoherë që vlera e mbartur e një aktivi ose njësia e tij e gjenerimit të parasë tejkalon shumën e tij të rikuperueshme. Njësi para-gjeneruese është njësia më e vogël e identifikueshme e grupimit të aktiveve që gjeneron flukse monetare të pavarura nga aktive dhe grupe të tjera. Humbja nga rënia në vlerë njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Vlera e rekuperueshme e një mjeti ose një njësie para-gjeneruese është vlera më e lartë midis vlerës së përdorimit dhe vlerës reale pasi janë zbritur kostot e shitjes. Në përafrimin e vlerës në përdorim, flukset e pritshme për t'u arkëtuar aktualizohen duke përdorur një normë të rregulluar për efektin e taksës që reflekton vlerësime të krahasueshme me tregun të vlerës në kohë të parasë si dhe rreziqeve që lidhen me aktivin.
Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat e mëparshme janë vlerësuar në çdo datë raportimi për ndonjë tregues që humbja është zvogëluar apo nuk ekziston më. Një humbje nga zhvlerësimi është i kundërt, nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi është i kundërt vetëm në masën që vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të kishte qenë vendosur, neto i amortizimit ose amortizimin, në qoftë se nuk ka humbje nga zhvlerësimi ishte njohur.

## l) Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme të sigurimit dhe të tjera llogari të arkëtueshme paraqiten në koston e tyre minus humbjet nga provigjonet.

Llogaritë e arkëtueshme të sigurimit vlerësohen për zhvlerësim në çdo datë raportimi.

## m) Kapitali aksioner

Kapitali aksioner njihet në vlerë nominale.

## n) Njohja e të ardhurave

Politikat kontabël për njohjen e të ardhurave nga kontratat e sigurimit janë paraqitur në notën 3.d.

## o) Shpenzimet

**Shpenzimet operative**
Pagesat për qeratë operative njihen në fitim ose humbje në bazë lineare mbi termat e pagesave të qerasë. Qeratë e marra njihen si pjesë integrale e totalit të shpenzimeve për qeratë.

## p) Shpenzimet e marrjes në sigurim

Shpenzimet e marrjes në sigurim përcaktohen si kosto që rrjedhin nga blerja e kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë edhe kostot direkte, të tilla si komisionet e blerjes dhe kostot e krijimit të dokumentit të sigurimit dhe pjesën e shpenzimeve administrative që lidhen me proçesin e propozimit dhe emetimit të policave. Shpenzimet e marrjes në sigurim njihen si shpenzime kur lindin.

## q) Përfitimet e punonjësve

**(i) Kontributet shoqërore të detyrueshme**

Grupi paguan vetëm kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore që i sigurojnë punonjësve përfitime pensioni kur këta të fundit dalin në pension. Autoritetet respektive të sigurimeve shoqërore të çdo juridiksioni legal kanë përgjegjësinë të sigurojnë kufirin e minimumit legal të pagesës për pension nën skemën e planit të pensionit me kontribute të përcaktuara. Kontributet e Grupit për planin e përfitimit të pensionit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin që ato lindin.

**(ii) Leja vjetore e paguar**

Grupi njeh si detyrim shumën e pa skontuar të kostove të parashikuara në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në shkëmbim të shërbimeve të punonjësve për periudhën e përfunduar.

### r) Qeratë

Qeratë, në të cilat një pjesë e mirë e rrezikut dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga Grupi klasifikohen si qera financiare. Në njohjen fillestare aktivi financiar matet me shumën më të vogël ndërmjet vlerës së drejtë dhe vlerës së aktualizuar të pagesave minimale të qerasë. Pas njohjes fillestare aktivi kontabilizohet në përputhje me politikat kontabël të aplikueshme për këtë aktiv. Pagesat minimale të bëra për qiratë financiare ndahen në shpenzimeve financiare dhe reduktimit të detyrimit të papaguar. Shpenzimet e financave janë ndarë për secilën periudhë gjatë afatit të qirasë në mënyrë që të paraqesë një normë interesi periodike konstante mbi shumën e papaguar të detyrimit
Qeratë, në të cilat një pjesë e mirë e rrezikut dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qeradhënësi klasifikohen si qera operative. Pagesat e bëra për qeratë operative njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në bazë lineare për të gjithë periudhën e qerasë.

### s) Tatimi

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe atë të shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me përjashtim të pjesës që lidhet me zëra të njohur në mënyrë direkte në kapital ose në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse.
Tatimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normat e tatimit në datën e raportimit. Tatimi mbi fitimin llogaritet duke axhustuar fitimin statutor përpara taksave për disa zëra të të ardhurave dhe shpenzimeve siç kërkohet nga Ligji Shqiptar.
Tatimi i shtyrë njihet për sa i përket diferencave të përkohëshme ndërmjet vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllim raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllim tatimor. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato kthehen mbrapsht, bazuar në ligjet që janë në fuqi ose pranë miratimit në datën e raportimit.
Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoret. Tatimi i shtyrë rishikohet çdo datë raportimi dhe zvogëlohet deri në masën sa nuk ka më mundësi që përfitimi nga tatimi mund të realizohet.

### t) Standartet e reja dhe interpretimet të cilat nuk janë adoptuar akoma

Një numër i ri standardesh, interpretimesh të Standardeve dhe rishikime të standarteve janë bërë efektive për periudhat që fillojnë nga 1 Janar 2013, dhe nuk janë aplikuar më herët në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Asnjë nga këto nuk pritet që të ketë efekt të rëndësishëm për pasqyrat e Grupit, përveç SNRF 9 Instrumentat Financiarë, e cila bëhet e detyrueshme për pasqyrat financiare të Grupit në 2015 dhe mund të ndryshojë klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare. Grupit nuk ka në plan të adoptojë këtë standart më përpara dhe niveli i ndikimit nuk është përcaktuar.

# 4. MENAXHIMI I RREZIQEVE TË SIGURIMEVE

### a) Objektivat e menaxhimit të rreziqeve dhe politikat për të ulur rrezikun e sigurimit

Rreziku nga kontratat e sigurimit është mundësia që ngjarja e siguruar ndodh dhe pasiguria për shumën e dëmit. Për vetë natyrën e kontratave të sigurimit, ky rrezik është i zakonshëm dhe i paparashikueshëm. Grupi e pranon rrezikun nga sigurimi nëpërmjet kontratave të sigurimit dhe disa kontratave të investimeve ku ajo supozon rrezikun e humbjes nga personat ose organizatat që janë të lidhura direkt me humbjen. Grupi është i ekspozuar ndaj pasigurisë së kohës, frekuencës dhe ashpërsisë së dëmeve nën këto kontrata.
Risigurimi blihet nga Grupi për të ulur rrezikun potencial nga humbjet si pasojë e ngjarjeve të mëdha individuale ose katastrofa dhe gjithashtu për të patur akses nga specialistë të rreziqeve dhe asistencë në menaxhimin e kapitalit. Policat e risigurimit nënshkruhen me risigurues të aprovuar në bazë proporcionale ose në bazë të marrëveshjeve për humbjen.
Kapitali rregullator menaxhohet (por jo vetëm) duke iu referuar rrezikut të sigurimit ndaj të cilit Grupi është i ekspozuar. Për një portofol të kontratave të sigurimit ku teoria e propabilitetit është aplikuar për vendosjen e çmimit dhe provigjonimin, rreziku kryesor që Grupi ka nga kontratat e saj të sigurimit është se dëmet aktuale dhe pagesat e përfituesit janë më të mëdha se vlera e mbartur e detyrimeve të sigurimit. Kjo mund të lindë sepse frekuenca ose ashpërsia e dëmit dhe përfitimit janë më të mëdha se llogaritja. Ngjarjet e sigurimit janë të rastësishme dhe numri aktual i dëmeve dhe përfitimeve mund të ndryshojë nga viti në vit nga niveli i caktuar nga teknikat statistikore. Eksperienca tregon se sa më i madh të jetë portofoli i kontratave të njëjta të sigurimit aq më e vogël do të jetë varianca relative e rezultateve. Gjithashtu, një portofol i diversifikuar më shumë ka më pak mundësi që të ndikohet nga ndryshimet në portofol.

## b) Strategjia e marrjes në sigurim

Grupi ka zhvilluar strategjinë e saj të marrjes në sigurim duke diversifikuar llojin e rreziqeve të cilat ajo pranon dhe brenda secilës kategori të arrijë një popullatë rreziku relativisht të madhe për të ulur lëvizshmërinë e rezultateve të pritshme.

## c) Termat dhe kushtet e kontratave të sigurimit

Termat dhe kushtet e kontratave të sigurimit të cilat kanë një efekt material mbi vlerën, kohën dhe pasigurinë e flukseve të ardhshme të parasë janë paraqitur më poshtë.

**Natyra e rrezikut të mbuluar**
Përgjithësisht, të gjitha produktet e Grupit mbulojnë rrezikun e vdekshmërisë të tilla si paaftësitë e përkohshme ose të përhershme, mbulimin e shpenzimeve mjekësore, shpenzimet spitalore dhe të riaftësimit. Produktet e tjera nga Jeta e Debitorit dhe Jetës me Kursim kanë karakteristika të njëjta të produkteve me afat të shkurtër dhe janë të rinovueshme çdo vit me opsionin për të ndryshuar primin nga Grupi.
Policat e jetës me kursim përmbajnë elemente kursimi dhe rreziku. Përfitimi në rast vdekje është i barabartë me pjesën e rezervës për kursimin dhe shumën e siguruar e cila është nga 1,000 Euro deri në 10,000 Euro. Përfitimi në rast maturimi është i barabartë me pjesën e rezervës për kursimin. Primi është i ndarë në dy pjesë, pjesa e rrezikut e vendosur në fillim të kontratës dhe pjesa e kursimit.
Policat e sigurimit për shëndetin dhe të tjera kategori paraqesin polica me afat pa elemente kursimi dhe vlerë të kthyeshme. Përfitimi nga policat e sigurimit të shëndetit paguhet në rast vdekje të të siguruarit ose paaftësie të përkohshme ose të përhershme brenda një periudhe specifike.

## d) Risigurimi dhe përqëndrimi i rrezikut

Risigurimi përdoret për të menaxhuar rrezikun e sigurimit. Megjithatë kjo nuk heq përgjegjësinë e Grupit si siguruesi kryesor. Nëse risiguruesi nuk paguan një dëm për arsye të ndryshme, Grupi është i detyruar që të paguajë policëmbajtësin për detyrimin. Grupi ka ceduar rrezikun e sigurimit për të limituar ekspozimin ndaj humbjeve dhe për të minimizuar efektin e humbjeve nga sigurimi i jetës për kreditë nëpërmjet marreveshjeve risiguruese. Tabela e mëposhtme paraqet përfitimet e agreguara të fundvitit për kontratat e sigurimit të jetës së kredimarrësve sipas moshës për 31 dhjetorin 2013 dhe 2012. Analiza e ekspozimit kontraktual konsiderohet si treguesi më i mirë për përqëndrimin e rrezikut të sigurimit.
Mosha për Sigurimin e Jetës së Kredimarrësve

| Mosha për Sigurimin e Jetës së Kredimarrësve | 31 dhjetor 2013 | % |
|---|---|---|
| Deri në 29 | 3,273,795,709 | 13% |
| 30 – 39 | 5,971,896,798 | 23% |
| 40 – 49 | 10,342,166,511 | 40% |
| 50 – 59 | 5,844,947,722 | 23% |
| Mbi 60 | 393,651,364 | 2% |
| **Totali** | **25,826,458,104** | **100%** |

| Mosha për Sigurimin e Jetës së Kredimarrësve | 31 dhjetor 2012 | % |
|---|---|---|
| Deri në 29 | 3,116,080,962 | 11% |
| 30 – 39 | 7,496,597,940 | 26% |
| 40 – 49 | 11,650,340,333 | 41% |
| 50 – 59 | 5,446,595,685 | 19% |
| Mbi 60 | 970,924,059 | 3% |
| **Totali** | **28,680,538,979** | **100%** |

## e) Ekspozimi që lidhet me ngjarjet katastrofike

Grupi merr në konsideratë se gjatë aktivitetit të tij të sigurimit ai nuk ka akumuluar ekspozim që lidhet me ngjarjet katastrofike.

# 5. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Transaksionet me instrumentat financiare rezultojnë për Grupin që të llogarisë rrezikun financiar. Këto përfshijnë rrezikun e tregut, rrezikun e kredisë (duke përfshirë rrezikun e kredisë nga risiguruesi) dhe rrezikun e likuiditetit. Secili nga këto rreziqe është i përshkruar më poshtë sëbashku me një përmbledhje të mënyrave se si Grupi i menaxhon këto rreziqe.

## a) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut përfshin tre lloje rreziqesh:
Rreziku valutor – rreziku që vlera e instrumentave financiarë do të variojë nga ndryshimet në kurset e këmbimit.
Rreziku i vlerës së drejtë të normës së interesit – rreziku që vlera e instrumentave financiare do të variojë nga ndryshimet në treg të normës së interesit.
Rreziku i çmimit – rreziku që vlera e instrumentave financiare do të variojë si rezultat i ndryshimeve të çmimeve të tregut, qofshin këto ndryshime si rezultat i faktorëve specifik të instrumentit financiar ose faktorë që ndikojnë të gjithë instrumentat financiarë që janë në treg.
Rreziku i tregut nuk përfshin vetëm mundësinë për të humbur ,por edhe mundësinë për të fituar.
Kurset e këmbimit të përdorura më 31 Dhjetor 2013 dhe 2012 janë kurset zyrtare të Bankës së Shqipërisë (Lek ndaj monedhave të huaja) të paraqitura si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2013 | 31 dhjetor 2012 |
|---|---|---|
| USD | 101.86 | 105.85 |
| EUR | 140.20 | 139.59 |

**Përputhja aktive/detyrim**
Grupi i menaxhon aktivet duke përdorur një mënyrë që balancon cilësinë, diversifikimin, përputhjen aktive-detyrime, likuiditetin dhe të ardhurat nga investimet. Qëllimi i proçesit të investimit është që të optimizojë të ardhurat nga investimi ndërkohë që siguron që aktivet dhe detyrimet janë menaxhuar në bazë të fluksit të parave dhe zgjatjes së tyre.
Natyra e rrezikut të sigurimit, maturimi i tyre dhe struktura e monedhës së vendosur për të shprehur detyrimin kanë një ndikim tek strategjia e investimit të Grupit. Gjithashtu Grupi duhet të plotësojë limitet e vendosura nga rregulluesit e sigurimeve të cilët kërkojnë që aktivet financiare të investuara në institucionet jo-financiare nuk duhet të kalojnë limitin prej 10% të kapitalit aksioner. Grupi vendos objektiva për portofol asetesh për cdo produkt sigurimi, gjë që përfaqëson strategjinë e investimit të përdorur për të financuar detyrimet brënda niveleve të pranueshme të rrezikut. Këto strategji përfshijnë objektiva për kohëzgjatjen, ndjeshmërinë, likuiditetin, përqëndrimin e sektorit të aktiveve dhe cilësinë e kreditit. Llogaritjet e përdorura për të përcaktuar sasitë e përafërta dhe kohën e pagesave të detyrimeve ndaj të siguruarve vlerësohen rregullisht.
Shumica e këtyre llogaritjeve janë subjektive dhe mund të ndikojnë në aftësinë e Grupit për të arritur objektivat e menaxhimit të aseteve/detyrimeve. Grupi ka ndërrmarrë disa transaksione në monedhë të huaj. Kështu që, ekspozimi ndaj lëvizjeve në kursin e këmbimit rritet.
Grupi ka ekspozim minimal ndaj rrezikut valutor sepse aktivet financiare të Grupit përputhen kryesisht me të njëjtat monedha me detyrimet e sigurimit dhe kontratat e investimeve. Si rezultat, rreziku nga këmbimet valutore lind nga aktive dhe detyrime të tjera në monedha të tjera.

## b) Menaxhimi i rrezikut të këmbimeve valutore

Aktivet dhe detyrimet në monedhë të huaj më 31 Dhjetor 2013 janë si më poshtë (shumat të përkthyera në Lek):

## SiCRED sh.a. Shënime të pasqyrave të konsoliduara financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

| | Në LEK | Në EUR | Në USD | Totali |
|---|---|---|---|---|
| **Aktivet** | | | | |
| Mjete monetare në arkë dhe bankë | 5,531,091 | 2,887,121 | 43,023 | 8,461,235 |
| Depozitat me afat dhe interesat përkatës | 386,469,936 | 153,427,904 | 43,437,624 | 583,335,464 |
| Aktivet e risigurimit | 2,488,167 | 8,717,356 | 205,757 | 11,411,280 |
| Të arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi | 171,869,376 | 205,759,337 | 1,206,064 | 378,834,777 |
| Shpenzime të marrjes në sigurim të shtyra | 7,944,104 | - | - | 7,944,104 |
| Të arkëtueshme nga tatim fitimi | 5,005,116 | - | - | 5,005,116 |
| Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura | 5,492,402 | - | - | 5,492,402 |
| Aktive të tjera | 13,242,906 | 1,605,437 | - | 14,848,343 |
| **Totali i aktiveve** | **598,043,098** | **372,397,155** | **44,892,468** | **1,015,332,721** |
| | | | | |
| **Detyrimet dhe kapitali aksioner** | | | | |
| Detyrimet nga humbjet dhe rregullimet për humbjet | 8,054,920 | 3,120,953 | - | 11,175,873 |
| Primi i pafituar dhe rezerva të tjera | 52,035,001 | 141,766,168 | 654,655 | 194,455,824 |
| Të ardhura të periudhave të ardhshme | 126,582,593 | 189,673,230 | 1,183,868 | 317,439,691 |
| Detyrime për sigurimin dhe risigurimin | 44,880 | 646,494 | 1,732 | 693,106 |
| Detyrime ndaj institucioneve financiare | - | 13,908,502 | - | 13,908,502 |
| Detyrime të tjera | 12,381,313 | 10,608,038 | 1,223 | 22,990,574 |
| **Totali i detyrimeve** | **199,098,707** | **359,723,385** | **1,841,478** | **560,663,570** |
| **Pozicioni neto** | **398,944,391** | **12,673,770** | **43,050,990** | **454,669,151** |

Aktivet dhe detyrimet në monedhë të huaj më 31 Dhjetor 2012 janë si më poshtë (shumat të përkthyera në Lek):

| | Në LEK | Në EUR | Në USD | Totali |
|---|---|---|---|---|
| **Aktivet** | | | | |
| Mjete monetare në arkë dhe bankë | 11,258,479 | 1,574,891 | 105,133 | 12,938,503 |
| Depozita me afat | 352,995,803 | 135,555,473 | 45,182,694 | 533,733,970 |
| Investime në letra me vlerë | 15,270,009 | - | - | 15,270,009 |
| Aktivet e risigurimit | 2,305,277 | 11,580,806 | 438,960 | 14,325,043 |
| Të arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi | 186,091,343 | 165,164,416 | 723,564 | 351,979,323 |
| Shpenzime të marrjes në sigurim të shtyra | 771,063 | 2,761,863 | - | 3,532,926 |
| Të arkëtueshme nga tatim fitimi | 12,192,433 | - | - | 12,192,433 |
| Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura | 5,143,902 | - | - | 5,143,902 |
| Aktive të tjera | 5,722,382 | 728,873 | - | 6,451,255 |
| **Totali i aktiveve** | **591,750,691** | **317,366,322** | **46,450,351** | **955,567,364** |
| | | | | |
| **Detyrimet dhe kapitali aksioner** | | | | |
| Detyrimet për humbjet dhe rregullimet për humbjet | 2,360,581 | 3,120,953 | - | 5,481,534 |
| Primi i pafituar dhe rezerva të tjera | 46,356,483 | 115,775,806 | 452,721 | 162,585,010 |
| Të ardhura të periudhave të ardhshme | 110,598,789 | 156,850,357 | 639,698 | 268,088,844 |
| Detyrime për sigurimin dhe risigurimin | 202,320 | 5,048,538 | 28,580 | 5,279,438 |
| Detyrime ndaj institucioneve financiare | - | 26,415,485 | - | 26,415,485 |
| Detyrime të tjera | 10,169,130 | 12,629,749 | 4,129 | 22,803,008 |
| **Totali i detyrimeve** | **169,687,303** | **319,840,888** | **1,125,128** | **490,653,319** |
| **Pozicioni neto** | **422,063,388** | **(2,474,566)** | **45,325,223** | **464,914,045** |

## c) Analiza e riçmimit të normës së interesit

Tabelat e mëposhtme paraqesin aktivet dhe detyrimet financiare të Grupit të analizuara në bazë të periudhave të riçmimit e përcaktuar si periudha më e hershme midis periudhës së mbetur deri në maturim sipas kontratës dhe periudhës së riçmimit sipas kontratës. Tabelat janë një llogaritje e rrezikut të normës së interesit për grupin më 31 Dhjetor 2013 dhe 31 Dhjetor 2012 dhe nuk janë tregues për periudha të tjera gjatë vitit por japin një të dhënë për ndjeshmërinë e të ardhurave të Grupit ndaj lëvizjeve në normat e interesit. Të ardhurat ndikohen gjithashtu dhe nga monedha e aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit. Grupi ka një pjesë të rëndësishme të aktiveve që mbartin interesa të shprehura në monedhë të huaj.

# 5. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

## c) Analiza e riçmimit të normës së interesit (vazhdim)

| 2013 | Norma efektive e interesit | Deri në 6 muaj | 6-12 muaj | 1-2 vite | 2-5 vite | Më tepër se 5 vite | Shuma me norma fikse | Që nuk mbartin interes | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Aktive Financiare | | | | | | | | | |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to | | - | - | - | - | - | - | 8,461,235 | 8,461,235 |
| Depozita me afat | 3.13% | 334,675,686 | 248,659,778 | - | - | - | - | - | 583,335,464 |
| Investime në letra me vlerë | | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Totali i aktiveve financiare | | 334,675,686 | 248,659,778 | - | - | - | - | 8,461,235 | 591,796,699 |
| Detyrimet financiare | | | | | | | | | |
| Detyrime ndaj institucioneve financiare | 6.80% | 7,282,428 | 6,626,074 | - | - | - | - | - | 13,908,502 |
| Totali i detyrimeve financiare | | 7,282,428 | 6,626,074 | - | - | - | - | - | 13,908,502 |

| 2012 | Norma efektive e interesit | Deri në 6 muaj | 6-12 muaj | 1-2 vite | 2-5 vite | Më tepër se 5 vite | Shuma me norma fikse | Që nuk mbartin interes | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Aktive Financiare | | | | | | | | | |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to | | - | - | - | - | - | - | 12,938,503 | 12,938,503 |
| Depozita me afat | 6.09% | 410,190,205 | 123,543,765 | - | - | - | - | - | 533,733,970 |
| Investime në letra me vlerë | 4.87% | - | - | 15,270,009 | - | - | - | - | 15,270,009 |
| Totali i aktiveve financiare | | 410,190,205 | 123,543,765 | 15,270,009 | - | - | - | 12,938,503 | 561,942,482 |
| Detyrimet financiare | | | | | | | | | |
| Detyrime ndaj institucioneve financiare | 6.80% | 18,113,189 | 1,707,316 | 3,565,903 | 3,029,077 | - | - | - | 26,415,485 |
| **Totali i detyrimeve financiare** | | **18,113,189** | **1,707,316** | **3,565,903** | **3,029,077** | **-** | **-** | **-** | **26,415,485** |

## d) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë i referohet rrezikut që pala tjetër do të dështojë në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale duke sjellë humbje financiare për Grupin. Grupi është i ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë në depozitat me afat dhe të arkëtueshmet nga sigurimi dhe risigurimi i palës tjetër. Menaxhimi beson se rreziku i kredisë i lidhur me depozitat me afat nuk është i rëndësishëm.
Grupi e menaxhon ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë në baza të vazhdueshme duke monitoruar vazhdimisht të arkëtueshmet nga sigurimi dhe risigurimi.
Të arkëtueshmet nga sigurimi dhe risigurimi më 31 Dhjetor 2013 sipas maturitetit janë si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2013 | % |
|---|---|---|
| Më pak se 1 muaj | 18,351,580 | 5% |
| 1 – 3 muaj | 5,884,942 | 2% |
| 3 muaj deri në 1 vit | 57,902,420 | 15% |
| Më shumë se një vit | 296,695,835 | 78% |
| **Totali** | **378,834,777** | **100%** |

Të arkëtueshmet nga sigurimi dhe risigurimi më 31 Dhjetor 2012 sipas maturitetit janë si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2012 | % |
|---|---|---|
| Më pak se 1 muaj | 20,040,250 | 6% |
| 1 – 3 muaj | 9,313,300 | 3% |
| 3 muaj deri në 1 vit | 69,415,335 | 20% |
| Më shumë se një vit | 253,210,438 | 72% |
| **Totali** | **351,979,323** | **100%** |

## e) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Grupi nuk do të mund të përballojë detyrimet që lidhen me detyrimet financiare kur ato lindin. Grupi ka adoptuar një strukturë të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit për menaxhimin e kërkesave të likuiditetit të Grupit. Grupi e menaxhon rrezikun e likuiditetit duke mbajtur mjete monetare bankare dhe rezerva për huatë duke monitoruar vazhdimisht flukset monetare të parashikuara dhe aktuale dhe duke përputhur maturitetin e aktiveve dhe detyrimeve.
Grupi është e ekspozuar ndaj rrezikut të likuiditetit që lind nga klientët si pasojë e kontratave të sigurimit.
Menaxhimi i likuiditetit siguron që Grupi ka fonde të mjaftueshme për të mbuluar dëmet nga sigurimi dhe detyrimet e maturuara.

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 Dhjetor 2013 (shumat e skontuara) është si më poshtë:

| | Më pak se 1 muaj | 1-3 muaj | 3 muaj deri në 1 vit | 1 – 5 vite | Më shumë se 5 vite | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Aktive monetare | | | | | | |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to | 8,461,235 | - | - | - | - | 8,461,235 |
| Depozita me afat | 199,276,485 | 15,000,000 | 369,058,979 | - | - | 583,335,464 |
| Investime në letra me vlerë | - | - | - | - | - | - |
| Aktivet e risigurimit | 11,411,280 | - | - | - | - | 11,411,280 |
